



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**ZL.Anr.714/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelet e parashtuara nga Valdona Ferizi, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga subjekti politik Nisma për Kosovë, dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

#### **V E N D I M**

**Refuzohen** si të pabazuara apelet e parashtuar nga Valdona Ferizi, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga subjekti politik Nisma për Kosovë, dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

#### **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 09.11.2017 ka pranuar dy apele ZL Anr 714/2017, dhe ZL Anr 725/2017, të parashtuara nga Valdona Ferizi, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga subjekti politik Nisma për Kosovë, dega në Lipjan në të cilat pretendon se në qendrat e votimit 1333E dhe 1321E qëllimisht i janë keqpërdorur votat nga njerzit të cilet kanë qenë përgjegjës për ruajtjen e votave.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar apelet dhe i ka trajtuar si një apel të evidentuar me ZL Anr. 714/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të gjitha apelet vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së apeleve dhe vlerësimit të pretendimeve ankimor, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se: